



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Kopshti" Sh.P.K. të datës 06.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve IV LLOTE" me nr. të prokurimit 616-23-269-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Kopshti" Sh.P.K. e datës 06.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve IV LLOTE" me nr. të prokurimit 616-23-269-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Kopshti" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Kopshti" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 06.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve IV LLOTE" me nr. të prokurimit 616-23-269-5-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) – “Ju si AK keni shkelur Nenin 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, sepse ne jemi OE me oferte me te ulet sipas renditjes... Sipas Nenit 60 - Kriteret per Dhënien e Kontratës, ne jemi OE me tenderin me te favorshem me cmimin me te ulet, si dhe te pergjegjshem...”.

Pretendimi i dytë (II) – “Grupi I OE:FLAMURI V SHPK dhe N.T.FLAMURI SHPK dhe BESIONI SH.P.K, Ankesin 2 DEKLARATA NEN BETIM, nuk e kane te plotesuar sipas aneksit te dosjes se tenderit te paraqitur permes prokurimit punlik te kesaj kontrate”.

Pretendimi i tretë (III) – “OE gjate perpilimit te konzerviumit nuk e ka plotesuar Nenin 2 tek Koncerziumi per project. Ku nuk e ka te definue she ne mes te kujt eshte arritur marrveshja per kete kontrate, andaj ky grup I OE nuk e definuar marrveshjen e Konzerciumit ne ne mes te cilave kompani eshte krijuar, dhe tregon mos pergjegjesi te grupit ekonomik”.

Pretendimi i katërt (IV) – “Sipas marveshjes per qiramarrje ndermejet Benita Company SH,P.K. dhe kompnise FLAMURI V SH.P.K, kane paraqitur listen e paisjeve ku eshte paraqitur Kompresor Ajri ABKS 500L, dhe e njejta eshte paraqitur edhe tek Aneksi 8. Per kete paisje - Kompresor Ajri ABKS 500L nuk eshte parqaitur asnje dokumentacion I nevojshem si dud doganor dhe asnje faktur blerjere”.

Pretendimi i pestë (V) – “Siguria e tenderit e Dorzuar nga OE tregon qe eshte dorzuar vetem ne emer te OE Flamuri SH.P.K., dhe nek eshte bere sigurimi ne emer te grupit te operatoreve, e qe realisht I bie qe persiguri te tenderit nuk merr pergjegjesi kompania tjeter e konzerciumit”.

Pretendimi i gjashtë (VI) – “Grupi I opertoreve ekonomik e me konkretisht kompania OE FLAMURI V SHPK dhe N.T.FLAMURI SHPK dhe BESIONI SH.P.K., kane tenderuar me cmim mbi bugjetin e percaktuar per kete kontrate, me kontretisht per LOT III me vlere: LLOT III-200000€, kurse grupi I OE ka tenderuar me cmim: 226901.45 euro, ku teljkalon bugjetin dhe parashikimet per perfundimin e punimve per kete kontrate”.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 72 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 12.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parë (I) – nga dosja e tenderit nenit 30.1 është gjetur se Kriteri i dhënies në këtë aktivitet është “Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6”.

Kriteret e Dhënies	30.1	[Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6 <input checked="" type="checkbox"/>
--------------------	------	---

Për këtë arsye pretendimi i parë i parashtruesit duke marrë parasysh dosjen e tenderit, është jorelevant dhe si i tillë në tërësi është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) dhe të tretë (III) - fillimisht duhet cekur se parashtruesi nuk ka specifikuar pretendimet e tij pasi që nuk ka elaboruar pse (sipas pretendimit të tij) deklarata nën betim dhe marrëveshja për konzorcium nuk janë plotësuar sipas DT dhe FDT. Në pretendimin e dytë parashtruesi vetëm konstaton që deklarata nën betim nuk është në përputhje me FDT mirëpo nuk tregon pse pretendon ai që ky dokument nuk është bazuar në FDT (cila pjesë e saj është plotësuar gabimisht dhe si është dashur që të plotësohet). Sidoqoftë, me qëllim të shqyrtimit të këtyre pretendimeve të parashtruesit është administruar si provë DT - FDT si dhe oferta e tenderuesit të rekomanduar. Nuk është aspak kontestuese që deklarata nën betim dhe marrëveshja e konsorciumit janë kritere të DT. Mirëpo nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar nuk është gjetur se deklarata nën betim nuk është në përputhje me FDT sikurse pretendon parashtruesi. Tutje është administruar edhe marrëveshja e konsorciumit ndërmjet OE tenderues të rekomanduar. Me këtë rast është gjetur se neni 1 në këtë marrëveshje përcakton saktësisht kush janë palë kontraktuese duke vërtetuar në këtë mënyrë pikërisht të kundërtën e pretendimit të tretë të parashtruesit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i dytë dhe i tretë i parashtruesit janë tërësisht të pabazuar.

Lidhur me pretendimin e katërt (IV) - është administruar si provë materiale DT - FDT si dhe oferta e tenderuesit të rekomanduar. Nuk është aspak kontestues fakti se kjo pajisje është kërkuar sipas DT-FDT. Kontestuese është nëse tenderuesi i rekomanduar ka ofruar dëshmi se e posedon këtë pajisje (faturë apo dud doganor). Me këtë rast është gjetur se tenderuesi i rekomanduar me rastin e ofertimit ka dorëzuar edhe faturën me nr. identifikues 20-SHV01-001-206 të dt. 30.06.2020 me të cilën ka dëshmuar se e posedon pajisjen në fjalë. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i katërt i parashtruesit është po ashtu i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin e pestë (V) - duhet cekur se fakti që sigurimi i tenderit është bërë nga liderit i grupit të OE është në përputhje të plotë me DT - FDT por edhe me LPP dhe RRPP. Në fakt as vet parashtruesi nuk e kundërshton këtë gjendje pasi që nuk ka treguar se cila dispozitë e LPP apo RRPP apo e DT-FDT është shkelur në këtë rast. Kjo për arsye se një shkelje e tillë nuk ekziston në mënyrën siç pretendohet nga parashtruesi. Do të ishte absolutisht e palogjikshme të kërkohet që nga secili anëtar i një grupi të OE të bëhet sigurimi i tenderit pasi që pikërisht në atë rast do të shkelej LPP dhe RRPP. Si shembull në rastin konkret sipas DT për LLOT 3 sigurimi i tenderit është përcaktuar në shumën 4,000.00 Euro. Në rastin konkret grupi i OE që janë tenderues të rekomanduar e kanë dorëzuar sigurimin e tenderit në përputhje të plotë me DT. Mirëpo nëse do veprohej sipas pretendimit të parashtruesit atëherë në rastin konkret vlera e sigurimit do të duhej të ishte 12,000.00 Euro (sepse janë tre anëtarë të grupit të OE). Pikërisht ky veprim do të ishte në kundërshtim me DT-FDT si dhe LPP dhe RRPP. Prandaj ky pretendim i parashtruesit përveç se është i pabazuar është edhe mjaft kundërthënës dhe iracional.

Lidhur me pretendimin e gjashtë (VI) – duhet theksuar se ky aktivitet i prokurimit është i ndarë në katër (4) lloje. Njoftimi mbi vendimi sipas tenderuesve të rekomanduar për secilin nga këto katër (4) lloje është përbrenda kornizës buxhetore të përcaktuar me deklaratën mbi disponueshmërinë e fondeve si dhe konfirmimin e njësisë kërkuese mbi buxhetin e disponueshëm për realizimin e të gjitha llojeve të këtij aktiviteti të prokurimit (duke përfshirë këtu edhe llotin III). Prandaj edhe pretendimi i gjashtë i parashtruesit është në tërësi i pabazuar.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 13.06.2023


Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.